



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Tergovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018, Vendimin nr. 5235 datë 15.07.2021 dhe Vendimin nr. 393/01 datë 09.06.2023 me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM), rritjen e investimeve, rritjes së eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

Thirrje publike për përkrahjen financiare të NMVM-ve në skemën e granteve për energji të pastër

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, respektivisht KIESA, Ministria e Ekonomisë dhe LuxDev, më datë 10.09.2025 kanë nënshkruar marrëveshjen për Skemën e granteve për Energji të Pastër. Qëllimi i kësaj skeme është të stimulojë angazhimin e sektorit privat në tranzicionin energjetik të Kosovës duke përdorur teknologji të qëndrueshme të prodhimit, duke rritur eficiencën e energjisë dhe duke ulur kostot operative.

Në këtë skemë ftohen Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim të bëhen pjesë e Skemës së Granteve për Energji të Pastër. Përveç tyre, të drejtë aplikimi kanë edhe kompanitë e tjera që kanë hyrë në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim. Vlera totale e skemës është 1 milion euro e financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

Skema bashkëfinancon investime që përmirësojnë performancën energjetike dhe ulin kostot e energjisë elektrike përmes: (i) gjenerimit të energjisë së ripërtërishme (sistemet solare fotovoltaike dhe termike), (ii) ruajtjes të energjisë elektrike nga sistemet solare fotovoltaike përmes baterive, (iii) masave të eficiencës së energjisë në ndërtesat e bizneseve, dhe (iv) pajisjeve që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit.

Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, MINT / KIESA ka përgatitur udhëzues për aplikant të cilët do t'i gjeni në linkun: <https://mint.rks-gov.net/> dhe <https://kiesa.rks-gov.net/>.

Thirrja për aplikim është e hapur nga data 10.10.2025 deri më datë 10.12.2025.